

Sektori i veprave civile të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 91 paragrafi 3 të Ligjit për gjykata ("Gazeta zyrtare e RM" nr.58/2006...96/2019), neni 68 të Rregullores gjyqësore ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 66/2013), dhe neni 41 të Rregullores së punës të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 13/1998 dhe 21/2009), në seancën e mbajtur me datë 25.02.2020, miratoi siç vijon:

M E N D I M J U R I D I K

Kërkesa për konstatimin e mosekzistimit të borxhit për shkak të parashkrimit të kërkesës, paraqet kërkesë për konstatimin e fakteve dhe nuk mund të theksohet me padi për konstatimin sipas dispozitave të Ligjit për procedurë kontestimore, dhe me padi të atillë as nuk kërkohet nga i padituri që të detyrohet të bëjë diçka, të durojë ose të lëshojë.

A r s y e t i m

Çështja juridike se si do të duhet të vendos gjyqi në kontest civil në të cilin kërkesë padia përfshin një pjesë deklarative, rrjedh nga qëndrimet kundërshtuese të gjyqeve gjatë vendimmarrjes, me këtë rast nevojitet sinkronizimi i praktikës gjyqësore dhe sigurimi i barazisë në zbatimin e ligjeve.

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur për çështjen e theksuar juridike i zbatoi dispozitat e nenit 177 paragrafi 1 të Ligjit për procedurë kontestimore.

Sipas nenit 177 paragrafi 1 të LPP, paditësi mund në padi të kërkojë që gjyqi vetëm ta konstatojë ekzistimin, respektivisht mosekzistimin e ndonjë të drejte ose baze juridike, ose autenticitetin, respektivisht jo autenticitetin e ndonjë dokumenti.

Bazë juridike është ajo bazë ndërmjet dy personave që është rregulluar me dispozita të caktuara për shembull ndonjë marrëveshje nga e drejta obliguese, ose baza e personave lidhur me ndonjë lëndë, për shembull, e drejta e pronës. Mundësi ligjore me padi deklarative të kërkohet konstatimi i ekzistimit ose mos ekzistimit të bazës juridike, nuk ka të bëjë edhe për konstatimin e ekzistimit të elementeve të një baze juridike. Kërkesa për konstatimin e mos ekzistimit të borxhit për shkak të parashkrimit, nga aspekti i humbjes së mbrojtjes gjyqësore për plotësimin e detyrueshëm të obligimit, për shkak të rrjedhjes së afatit të paraparë ligjor, është kryesisht kërkesë për konstatimin e faktit, që nuk mund të jetë lëndë e padisë deklarative. Në fakt, me padinë për konstatimin nuk mund të kërkohet që paditësi të detyrohet diçka të bëjë, të durojë ose lëshojë, ose një bazë juridike të transformohet, të formohet në një bazë tjetër juridike.

Në kuptim të së theksuarës, Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut konstaton se, nuk mund të theksohet me bazë që me kërkesë padi të konstatohet mos ekzistimi i borxhit për shkak të parashkrimit, por as edhe nga ajo arsye ti nënshtrohet palës së kundërt për të marrë veprime për vënien e gjendjes së mëparshme para ekzistimit të borxhit, me ç' rast vijonte që të sjellë mendimin e theksuar juridik.

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SEKTORI I VEPRAVE CIVILE**